



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
SEKTORI I MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

**STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË
KAFSHËVE ENDACAKE**

Përmbajtja

Strategjia e menaxhimit të qenve dhe maceve endacak.....	2
Strategjia e menaxhimit të qenve dhe maceve endacak.....	3
Hyrje.....	3
Arsyet e shtimit të kopeve të qenve endacak.....	4
Legjislacioni.....	6
Materiali dhe metoda.....	6

BIBLIOGRAFI

- Farhoud, N. (2021). Harrowing images show 61 dogs packed into cages on way to slaughter for meat. *Mirror*, 1.
- Horwitz, D., & Landsberg, G. (2021). Cat Behavior and Training - Cat Neutering and Behavior.
- Kwan, L. (2018). Netizen Shares How Stray Dogs Are Treated in Turkey & It's Really Heartwarming. *World of Buzz*, 1.
- Matthews, R. (2019). How To Start A Pet Transport Company. *Vet Practice News*, 1.
- Panorama.al. (August 2018). Shtohen shumë qentë endacakë, bashkia Lezhë: Sa të gjejmë zgjidhjen, i këshillojmë njerëzit të kenë besim te vetja dhe.... *Panormama*, 1.
- Pati, A. (2021). Civic body tightens leash on stray dogs. *The Telegraph*, 1.
- Williams, K., & Ward, E. (2021). Spaying in Dogs. 1.
-
- Figure 1 – Cikli biologjik i *Leishmania donovani* (IDEXX Laboratories Italia S.r.l.)..... 3
- Figure 2 – Cikli biologjik i *Echinococcus granulosus* (Center of control disease and prevention)4
- Figure 3 – Qen endacak në Laknas (01/12/2021) 5
- Figure 4 - Qen endacak Bathore(01/12/2021) 5
- Figure 5 – Qen i braktisur në rrugën Kamëz– Paskuqan 6
- Figure 6 – Skenë kapje mekanike të një qeni në Indi (Pati, 2021) 7
- Figure 7 – Si të transportohen kafshët e kapura (Mattheës, 2019) 8
- Figure 8 – Si mos të transportohen kafshët e kapura (Farhoud, 2021) 8
- Figure 9 –Mitra dhe vezore në bushtër dhe mace (Williams & Ward, 2021)..... 9
- Figure 10 –Testikuj në qen dhe dac (Horëitz & Landsberg, 2021) 9
- Figure 11 – Qentë në Kamëz pa matrikull 10
- Figure 12 – Qen i matrikulluar 10
- Figure 13 – Trajtimi post operator 11
- Figure 14 – Disa parazitë gjakthithës të përbashkët (rriqëra dhe mushkonja)..... 12
- Figure 15 – Biocan R® Vaksinim..... 13


STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË QENVE DHE MACEVE ENDACAK.

Hyrje

Qentë dhe macet endacakë kanë një rol të rëndësishëm në shoqërinë tonë pasi prej vitesh ata kanë bashkëjetuar me njerëzit në mënyrë simbiotike, duke iu shërbyer njerëzve dhe duke ju ofruar më të mirën e mundshme për ta. Siç e dimë qentë janë kafshët më besnike të cilët njerëzit kanë njohur deri më tani. Sot qentë dhe macet janë pjesë e pa ndarë e shoqërisë tonë njerëzore duke u konsideruar nganjëherë dhe pjestarë të familjeve. Përkundër të mirave të cilët ato kanë, mungesa e kontrollit të qenve dhe maceve si kafshë shoqëruese, mund të shkaktojë shqetësime në komunitet. Këto shqetësime përfshijnë rritjen e numrit të qenve dhe maceve endacak, gjë që rrezikon shëndetin dhe sigurinë publike si dhe mirëqenien e vetë kafshëve që jetojnë në rrugë.


Rëndësia e menaxhimit të tyre përbën në vetëvete mbrojtje për popullatën njerëzore dhe vetë kafshët endacak nga sëmundje të ndryshme sidomos ata me karakter zoonotik. Njerëzit (fëmijët) nganjëherë janë bërë pre e sulmeve të qenve endacak si pasojë e agresivitetit të tyre gjatë përrjudhës së shumëzimit të tyre. Shumë sëmundje me karakter zoonotik si “Leshmanioza”, “Ekinokokoza” etj në të cilën qentë janë mbartës drejtpërdrejtë të shkaktarit kanë prekur njerëzit duke çuar në situatë serioze për shëndetin e tyre. Më poshtë në Figurën 1 dhe në Figurën 2 paraqiten ciklet biologjike të dy parazitëve *Leishmania donovani* dhe *Echinococcus granulosus* të cilët si mund të shihet kanë si bujtës përfundimtar qenin, por njëkohësisht njeriun. Gjithashtu ndotja akustike që ato bëjnë duke shqetësuar familjarë dhe turistë kryesisht natën. Nganjëherë janë problem për qarkullimin e automjeteve (kryesisht në rrugët nacionale) duke u bërë burim aksidenti. Nga pikëpamja janë një imazh jo i mirë ndaj syve të turistëve, sidomos tek qentë e aksidentuar të cilët shfaqin mizori, qentë me sëmundje lëkurore apo sëmundje të tjera të jashtme si dhe qentë e ngordhur.

Figure 1 – Cikli biologjik i *Leishmania donovani* (IDEXX Laboratories Italia S.r.l.)



Shumim dhe shndërrim të promastigotëve brenda makrofagëve

Figure 2 – Cikli biologjik i *Echinococcus granulosus* (Center of control disease and prevention)



Menaxhimi i qenve endacak ul ndjeshëm problematika e lartëpërmendura duke e bërë popullaten e qenëve endacak më të qetë, më miqësore me njerëzit si dhe të sigurtë ndaj sëmundjeve të ndryshme që ato paraqesin sidomos sëmundjeve zoonotike. Në periudha të ndryshme të ciklit të tyre ato lëvizin në kope duke lehur e duke sulmuar njerëzit apo duke u bërë burim aksidentesh.

Arsyet e shtimit të kopeve të qenve endacake

Situata e kafshëve të rrugës ka ardhur si pasojë e braktisjes dhe lëshimit të këtyre kafshëve në rrugë nga pronarët e tyre të pa përgjegjshëm. Papërgjeshshmëria e tyre vjen si rezultat i gjendjes ekonomike të pronarit, emigracionit etj. Ka raste të cilët pronarët i braktisin edhe për shkak të mospëlqimit më të tyre, dhe më keq akoma edhe në rast kur ato janë të sëmurë dhe mungon vullneti i pronarit për ta mjekuar dhe zgjedh rrugen me të thjeshtë duke e braktisur, rrugë kjo shumë e dhimshme e cila bie ndesh me cdo normë njerëzore. Më pas si pasojë e ciklit biologjik që ato kanë popullata e tyre shtohet deri sa sot janë bërë problem më vete jo vetem për Bashkinë Kamëz por edhe në mbarë vendin.

Figure 3 – Qen endacak në Laknas

Rruga: Nënë Tereza



Figure 4 - Qen endacak në Bathore

Rruga : Bashkëjetesa



Figure 5 - Qen endacak në Paskuqan

Rruga: Havzi Nela



Legjislacioni

Bazuar në ligjin Nr. 10465 datë 29.09.2011 i ndryshuar me ligjin Nr.71/2020 neni 54 pika C “Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të mbajnë nën kontroll dhe të zbatojnë kërkesat e këtij ligji për kontrollin e qenve e të maceve të rrugës, duke bashkëpunuar me shërbimin veterinar shtetëror”, duke parë edhe situatën mjaft problematike Bashkisë Kamëz i lind detyrimi të hartojë dhe zbatojë një strategji në përputhje me Legjislacionin Veterinar Shqipëtar dhe konventat e Bashkimit Europian për të drejtat e kafshëve për zbutjen dhe eliminimin e kesajë shtate, duke mbrojtur shëndetin e qytetarëve, shëndetin e qenve dhe maceve endacak në territorin e Bashkisë Kamëz.

Materiali dhe metoda

Trajtimi dhe menaxhimi i qenve dhe maceve endacakë do të jetë gjithë-vjetor dhe duhet të bëhet nga një subjekt privat i cili duhet të plotësojë të gjitha standartet e kërkuara nga Bashkia Kamëz të cilat janë të bazuara në legjislacionin për vetëqeverisjen vendore dhe legjislacionin veterinar Shqipëtar në fuqi.

- Aktivitetet të cilat do të kryhen:

Aktivitetet që do kryhen konsistojnë në një sërë masash dhe veprimtarishë shumë frytdhënëse, konform legjislacionit veterinar si dhe konformë të gjitha direktivave dhe konventave Shqipëtare dhe të Bashkimit Europian për të drejtat e kafshëve. Aktivitetet në të cilën do të mbahen nuk duhet të kenë në fokus keqtrajtimin e kafshëve endacak prandaj metodat të cilat do të përdoren do të jenë të pranueshme dhe të raportohen periodikisht (cdo hallkë e aktivitetit) tek personat përgjegjës të ngarkuar nga Bashkia Kames për monitorimin e aktivitetit. Këto aktivitete do të jenë:

- 1- Monitorimi
- 2- Kapja e qenve dhe maceve
- 3- Transporti i qenve dhe maceve endacake
- 4- Kastrimi dhe Sterelizimi
- 5- Matrikullimi dhe regjistrimi
- 6- Trajtimi post-operator
- 7- Trajtimi antiparazitar
- 8- Vaksinimi

1- Monitorimi:

Monitorimi i situatës së qenve dhe maceve endacak paraprakisht është bërë nga specialistët e Bashkisë Kamëz dhe konsiston në praninë e përafersisht të 1000 (nje mije) qenëve endacak dhe 200 (dyqind) maceve endacake. Ata rrinë kryesisht në zonat ku aktiviteti i njerëzve është më i përqëndruar për arsye se e kanë më të thjeshtë të ushqyerin e tyre.

Monitorimi i vazhdueshëm do të bëhet periodikisht cdo muaj nga subjekti dhe të raportohet tek personi përgjegjës i ngarkuar për monitorim nga Bashkia Kamëz. Gjatë muajve të trajtimit të qenve dhe maceve endacak do të ketë përsëri pronarë të pa përgjegjshëm të cilët do ti braktisin kafshët e tyre dhe për pasojë mund të ketë dhe ndryshime në strategjinë e monitorimit.

2- Kapja e qenve dhe maceve.

Kapja e qenve dhe maceve duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë trauma dhe strese tek kafsha, e cila gëzon një nga pesë liritë kryesore të cilët janë: liria nga uria dhe etja, liria nga paretia, liria prej dhimbjes, liria prej dhunës dhe prej sëmundjes. Kapja duhet të bëhet me metoda bashkëkohore nga persona të specializuar dhe të çertifikuar nga Urdhëri Profesional i Mjekut Veteriner Shqipëtar për trajtimin e qenve dhe maceve endacake. Kapja duhet të bëhet me preparate si “acepromazine orale”, një preparat ky i cili nuk shkakton efekte anësore tek kafshët. Me anë të kësaj metode mënjanohen stresi ndaj kafshëve, lëndime e ndryshme si nga kafshët por edhe njerëzit të cilët i kapin. Mënjanohet gjithashtu mizoria që ato shfaqin gjatë kapjes tek njerëzit e tjerë sidomos tek turistët. Për efekt të fluksit të qenve duhet të ketë minimalisht dy grupe pune për kapjen e tyre me minimalisht dy persona ku njëri prej tyre duhet të ketë certifikatë nga Urdhëri Profesional i Mjekut Veteriner Shqipëtar për trajtimin e qenve dhe maceve endacak. Kapja do të bëhet pas orës 22⁰⁰ (njëzet e dy) në mbrëmje deri në orën 5⁰⁰ (pesë) të mëngjesit. Për cdo kapje do të njoftohet personi përgjegjës i ngarkuar për monitorim nga Bashkia Kamëz. Njoftimi do të bëhet paraprakisht për zonat ku do të bëhet kapja dhe pas kapjes të cilët në fund do të dokumentohet me foto

Figure 5 – Skenë kapje mekanike të një qeni në Indi (Pati, 2021)



3- Transporti i qenve dhe maceve endacakë.

Transporti duhet të bëhet me mjete të specializuara dhe të lejuara për transportin e kafshëve nga instancat e Shërbimit Veterinar Shtetëror. Subjekti i cili do të bëjë trajtimin dhe menaxhimin e qenve dhe maceve endacake duhet të ketë të pakten dy mjete transporti për arsye se gjatë fluksit të verës në zonat turistike do të ketë të pakten dy grupe pune për kapjen e qenve dhe maceve endacakë. Mjetet e transportit duhet të kenë në brëndësi të tyre kafaze të ndara. Për shkak të gjendjes sedative të kafshëve transporti duhet të zgjasë jo më shumë se 20 (njëzet) minuta. Gjatë transportit, transportuesi duhet të ketë kujdes dhe të tregohet shumë profesional në mënyrë që gjatë transportit të tyre mos të ketë përplasje të kafshëve brënda kafazeve. Një kujdes i vecantë duhet të tregohet edhe gjatë transportit nga klinika për në destinacion e qenve dhe maceve endacake sepse në këto kushte ato janë disi të dobët për shkak të trajtimit. Në cdo rast të transportit të kafshëve nga vendi i trajtimit e në destinacionin e ku janë marrë mjeti duhet të dezinfektohet dhe dezinfektohet për shkak se nuk duhet të kalojnë sëmundjet nga qentë apo macet e ardhura tek ato të trajtuara. Është e nevojshme që subjekti të ketë edhe liçensë dezinfektimi për shkak të dezinfektimit të herë pas herëshëm të mjetëve dhe klinikës të cilët do të bëjnë trajtimin e qenëve dhe maceve endacakë.

Për çdo lëshim që do të bëhet do të njoftohet përsonei përgjegjës i ngarkuar për monitorim nga Bashkia Kamëz. Përsonei përgjegjës i ngarkuar për monitorim nga Bashkia Kamëz merr pjesë herë pas herë gjatë lëshimit të kafshëve në territoret në të cilët ata janë marrë.

Figure 6 – Si të transportohen kafshët të kapura (Matthews, 2019)



Figure 7 – Si mos të transportohen kafshët e kapura (Farhoud, 2021)




4- Kastrimi dhe Sterelizimi

Kastrimi dhe Sterelizimi duhet të bëhet nga klinika të liçensuara. Kastrimi dhe sterelizimi duhet të bëhet 24 (njëzetekatër) orë pas kapjes për shkak se substanca e përdorur për kapjen e tyre nganjëherë ndikon negativisht me substancat sedative të tjera. Para operacionit kafshët duhet të lihen në vende të përshtatshme, të pastra dhe me kushte klimatike të përshtatshme. Për cdo rast duhet të bëhet trajtimi pre-operator i kafshëve dhe dieta e tyre në mënyrë që

operacionet të dalin me sukses. Operacioni duhet të bëhet nga mjekë veteriner profesionist, të licensuar nga Urdhri Profesional i Mjekut Veteriner Shqipëtar për ushtrimin e profesionit. Për shkak të fluksit që mund të ketë duhet që subjekti të ketë të pakten dy salla operatore, dhe të pakten dy mjekë veteriner dhe dy ndihmës veteriner. Mundet që ndihmësit të jenë mjekë veteriner ose teknikë veteriner të licensuar. Për trajtimet operatore mjekët veteriner profesionist mbajnë përgjegjësi për cdo operacion të cilët ato kryejnë. Operacionet duhet ti dokumentojnë me foto post-operatore tek specialist i Bashkisë Kamëz, pa çënuar të drejtat e kafshëve të cilat në gjendje sedative nuk është etike të fotografohen. Cdo qenë apo mace pas trajtimit nuk duhet të shfaq shënja afshi. Në rast se shfaqen shënja afshi edhe pas disa vitesh tek këta kafshë të cilët operohen subjekti mban përgjegjësi për punën e cunguar që ai ka kryer.

Figure 8 –Mitra dhe vezore në bushtër dhe Figure 9 –Testikuj në qen dhe dac (Horwitz & Landsberg, 2021)
mace (Williams & Ward, 2021)



5- Matrikullimi dhe regjistrimi

Matrikullimi dhe regjistrimi është një moment shumë serioz i strategjia e menaxhimit të qenëve dhe maceve endacak. Matrikullimi bëhet me matrikuj të posaçëm për qentë dhe macet endacakë. Matrikullimi konstaton në identifikimin e qenëve pas trajtimit duke u ndjerë të sigurtë për punën e kryer dhe në mënyrë që të mos i kapim disa herë. Cdo qen apo mace paiset me një kartelë të posaçme mjeksore e cila identifikohet në bazë të matrikullit dhe shënohet detaj për detaj cdo trajtim i tyre nga kapja e deri në lëshimin e tyre në vendin ku ata janë marrë. Cdo matrikullim, cdo kartelë dhe cdo shënim në në kartelë i jepet specialistit përgjegjës i ngarkuar për

monitorim nga Bashkia Kamëz. Specialisti i Bashkisë Kamë merr informacion periodik nga subjekti për çdo punë të bërë.

Figure 10 – Qentë në Kamëz pa matrikull
Rruga: Berisha




Figure 11 – Qen i matrikulluar



6- Trajtimi post-operator

Pas operacionit mbahen përsëri në vartësi të rastit nga katër deri në shtatë ditë. Trajtimi post operator konstaton me trajtimin me antibiotikë dhe kortizonikë si dhe trajtimin lokal të plagës. Në këtë pejudhë duhet treguar kujdes i vecantë në akomodimin i cili duhet dhe të ushqyerin e tyre i cili duhet të bëhet me ushqime të miratuara nga instancat shtetërore. Çdo trajtim shënohet në kartelën (regjistrin klinik) të çdo qeni apo maceje në mënyrë të vecantë. Për çdo situatë e cila mund të dali jashtë parashikimeve shëndetësore ato mbahen deri në trajtimin e plotë të tyre. Në asnjë moment nuk mund të zhvendosen pa e marrë veten plotësisht nga ana shëndetësore.

Figure 12 – Trajtimi post operator



Antibiotik lokal Spray

Antibiotik Përgjithshëm në rrugë paranterale

Fluidoterapi në raste të nevojshme

7- Trajtimi antiparazitar

Pas trajtimit post operatorë bëhet trajtimi me antiparazitarë të brëndshëm dhe të jashtëm. Antiparazitët duhet të jenë liçensuar dhe me efikasitet të plotë për të gjithë llojet e parazitëve. Cdo trajtim i përdorur shënohet në kartelën shëdetësore duke e shoqëruar dhe me stampën e produktit i cili duhet të tregojë numrin serial, numrin e lotit dhe datën e skadencës së produktit. Specialist i bashkisë shikon dhe mbanë shënim çdo detaj të regjistrit. Ky veprim ka rëndësi të jashtëzakonshëm profilaktik dhe mjekësor për kafshën. Gjithashtu është shumë e rëndësishme për mbikëqyrjen e shëndetit human duke qenë se shumë parazitë kanë si bujtës njeriun dhe mund të transmetohen nga qeni – mace te njeriu dhe shumë nga këto parazitë janë vektor sëmundjesh.

Figure 13 – Disa parazita gjakthithës të përbashkët (rriqëra dhe mushkonja)



8- Vaksinimi

Pasi qentë dhe macet endacakë të jenë të shëndetshëm plotësisht ata bëhen gati për lëshim dhe në këto momente vaksinohen me vaksinën e tërbimit. Vaksina duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të barërave në ministrinë e bujqësisë. Çdo vaksinim shënohet në kartelën shëndetësore duke e shoqëruar dhe me stampën e produktit i cili duhet të tregojë numrin serial, numrin e lotit dhe datën e skadencës së produktit. Vaksina duhet të bëhet dhe të injektohet kur qentë dhe macet të jenë totalisht të shëndetshme pasi nëse do të jenë të sëmurë tek ata sëmundja mund të agravohet ose vaksina nuk mund të jetë efektive.

Figure 14 – Biocan R® Vaksinim

